



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Berat, më 14/ 11/ 2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**PUNIME REHABILITUESE PËR KOPSHTIN MORAVË, SHKOLLËN DYSHNIK DHE  
QENDRËN E SHËRBIMEVE ARSIMORE BERAT**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45000000-7**  
**pune ndertimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 16 993 200** (Gjashtembëdhjetë milion e nenteqindë e nentedhete e tremijë e dyqind )**leke pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020, 2021** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, behet duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël***".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

### 2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **180%** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

e) *Faturat tatimore*

- Për kontrata për punë të realizuara me subjekte private kërkohen:
  - a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
  - b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
  - c) *Faturat tatimore,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

### **2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

- NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë.
- NP –3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale,veshje dhe fasada

**Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

- NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- NS - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- NS - 4 A Punime rifiniture dhe të lidhura me to
- NS- 12 A Impiante teknologjike , termike dhe te kondicionimit
- NS - 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj
- NS - 18 A Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente te ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur ne SPE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 1	Punime gërmimi në tokë	Punime sistemim i jashtëm (Qendra arsimore Berat) Germin dhe për hapje kanali (instalimi i tokezimit tek Qendra arsimore Berat) Punime për disiplinimin e ujerave të shiut në Shkollën Dushnik	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar
NP - 3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve të këtij objekti, pasi në tërësi kemi të bëjmë me rikonstruksion të një objekti ekzistuese, sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori.	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikua



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

		preventin e punimeve, konkretisht gjithë zërat e kapitullit A “Punime Prishje” per te tre objektet qe rikonstruktohen		r në VKM Nr. 42 date 16.01.2008 , i ndryshuar
NS-2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Punime hidrosanitare (shkolla Dushnik)	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008 , i ndryshuar
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Perfshihen te gjitha punimet per grup zerat : Punime suvatimi e bojatisje, punime dyersh e dritaresh, punime catie (Qendra arsimore Berat; Kopshti Morave Qender; Shkolla Dushnik)	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008 , i ndryshuar
NS-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	Pefshihet grupzeri i punimeve : sistemi HVAC ne Qendren arsimore Berat	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008 , i ndryshuar
NS- 14	Impiante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Perfshin grupzerin G Punime elektrike ne Qendren Arsimore Berat; Punime ne	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikua





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

		grupzerin F Punime elektrike te Kopshtit Morave Qender		r në VKM Nr. 42 date 16.01.2008 , i ndryshuar
NS - 18	Punime Topogjeodezike	Lidhet me piketimin e objektit, kuotat per sitemimin e sheshit etj.	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008 , i ndryshuar

**2.3.3** Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Kultures N-Z/A/6.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar ne Ligjin Nr. 27/2018 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETË .

Duke gene se Berati eshte qytet muze dhe objekti i Qendres se Sherbimeve Arsimore ka elemente arkitekture , te cilat duhen ruajtur , operatori duhet të paraqes licencën profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga Ministria e Kultures.

**2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- 1) Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- 2) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

- |                       |         |
|-----------------------|---------|
| 3) Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| 4) Inxhinier Gjeodet  | 1 (një) |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

*Për secilin pjestar te stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë , Librezë pune.*

**2.3.5** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Arkitekt                      1 (një)

**Argumentimi :** Kërkesat e pikës 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike sipas parashikimeve në projektet Hidrosanitare
- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të ndryshme të fasadës, sipas parashikimeve në projektet arkitektonike.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike, sipas parashikimeve në projektet Elektrike, si dhe referuar punimeve të parashikuara në kapitujt elektrik.
- **Inxhinieri Gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit, referuar zerave te preventivit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

**2.3.6.** Operatorët ekonomik ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë edhe **stafin mbështetës**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë/ ose certifikatë trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.
- 2. Manovratorët e makinerive të rënda të paraqiten deshmitë e drejtimit të leshuar nga Ministria perkatese për të paktën 3 (tre) manovratorë.
- 3. Për shoferat, të paktën 3 (tre) duhet të paraqiten dokument (Leje drejtimi, certifikate aftesimi), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

**Argumentimi :** Kërkesa e pikës 2.3.5/ 1, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Kërkesa e pikës 2.3.5/2 është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.7. Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë **punonjës të specializuar/ kualifikuar**, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, stafin teknik si më poshtë :

NR	EMËRTIMI	
1	Teknik Ndërtimi	( 2 persona )
2	Bojaxhinj	( 2 persona )
3	Karpentier	( 2 persona )
4	Hidraulik	( 1 ) person )
5	Elektracist	( 2 person )
6	Murator	( 2 persona )
7	Pllakashtrues	( 2 persona )
8	Hekurkthyes	( 1 person )
9	Suvatues	( 2 persona )

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

Dëshmi të kualifikimit profesional, dëshmi të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, **ose çertifikata ekuivalente të tyre ( të vlefshme )**.

**Argumentimi :** Kërkesat e pikës 2.3.6, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes, sipas zërave të preventivit.
- **Karponentieri** është i nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Elektriçisti** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Murator** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të muratues, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Pllakashtues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve për shtrimin e pllakave, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Hekurkthyes** është i nevojshëm për punimin e hekurit sipas nevojave, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Suvatuesi** është i nevojshëm për realizimin e suvatimeve, sipas zërave të preventivit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një **deshmi nga administrata tatimore** për punësimin mesatar jo më pak se **34 (Tridhjetë e kater)** punonjësish për periudhën Janar 2022 – deri në muajin e fundit që i takojnë deklaratimit, ku përfshihen edhe stafit menaxherial i drejtuesve Teknik.

**Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën e kërkuar.
- Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve.

Konkretisht :

• Drejtues teknik	5 (pese)
• Teknik ndertimi	2 (dy)
• Roje kantieri	6 (gjashte)
• Manovrator dhe shofera	6 (gjashte)
• Punonjes te kualifikuar (nga zberthimi i preventivit)	14 (katermbedhete)
• Pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune	1 (nje) punonjes
<i>Totali I punonjesve=</i>	<i>34 (tridhete e kater)</i>

*Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Nr i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetë shkarkues , kapaciteti mbajtës jo më pak 15 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamiocina kapaciteti mbajtës deri 3.5 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Fadroma me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc mbi 10 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopompe	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul 8-12 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozite uji me kapacitet minimum 5000 l	2 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	1000 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qera
Pompe betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	2 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë :**

- Kokore minimumi 34 copë
- Këpucë pune 34 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 15 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

- Jelek pune 34 cope
- Doreza pune 34 cope
- Tabela paralajmëruese për siguri në objekt minimumi 30 copë
- 

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 dhe dokumentacioni si më poshtë

:

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton pronesine mjetit, regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton pronesine mjetit, regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

*Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mesiperme jane vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa “d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

Makineritë janë përcaktuar në raport me punimet e parashikuara në preventiv dhe volumet e tyre, numrin e puntorisë dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të kontratës.

**Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:**

“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeteve transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeteve të transportit do të mbetet në qarkullim”.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Nr	Mjetet	Sasia	Punimet:
1.	Kamion vetë shkarkues, kapaciteti mbajtës jo më pak 15 ton	2 copë	Nevojiten për largimin e materialeve që dalin nga procesi i prishjeve
2.	Kamiocina kapaciteti mbajtës deri 3.5 ton	3 copë	Kamiocinat nevojiten për transportin e puntorisë në tre objektet që rikonstruktohen, transportin e materialeve elektrike, hidraulike etj.
3.	Eskavator me goma	1 cope	Punimet për disiplinimin e ujerave të shiut në Shkollën Dushnik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

4.	Fadroma me goma	1 cope	Punime per sistemimin e jashtem (Q. A.Berat)
5.	Autovinc mbi 10 ton	1 cope	Per ngritjen e materialeve te ndertimit
6.	Autobetoniere	2 cope	Per betonimet
7.	Autopompe	1 cope	Per betonimet
8.	Rrul 8-12 ton	1 cope	Punime per sistemimin e jashtem (Q. A.Berat)
9.	Betoniere kantieri	1 copë	Per llacet e e mureve
10.	Depozite uji me kapacitet minimum 5000 l	2 copë	Per te siguruar furnizimin me uje per betonimet dhe llacet
11.	Skeleri	1000 m <sup>2</sup>	Per ndertimin e mureve (ndertim, suvatim, bojatisje)
12.	Pompe betoni	1 cope	Per betonimet
13.	Matrapik	1 copë	Per prishjet
14.	Vibrator betoni	2 copë	Per ngjeshen e konstruksioneve b/a
15.	Gjeneratore	2 copë	Per sigurimin e energjise
16.	Saldatrice	2 copë	Per saldimet e nevojshme

#### 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :

- **ISO 9001:2015** ( Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme ), *ose ekuivalent*
- **OHSAS 18001-2007** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose **ISO 45001-2018**, *ose ekuivalentet e tyre.*
- **ISO 14001-2015** ( Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

- **PAS 99-2012** ( Sistemi i Integruar i Menaxhimit e vlefshme), *ose ekuivalent*
- **ISO 50001:2011** – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Energjise

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

*ISO 9001:2015 eshte ne seri normash dhe standartizimesh nderkombetare, qe i referohen sistemeve te menaxhimit cilesise, pra, te strukturave te organizimit te nderrmarjeve publike dhe private, struktura te cilat keto nderrmarje duhet t'i adoptone per nje orientim me te mire te nderrmarjes ne standartet e tregut. AK gjykon se cdo Ofertues duhet te jete i pajisur me ISO 9001:2015 me qellim efektivitetin dhe efektshmerine ne zhvillimin e veprimtarise se tij, e cila do te sjelle dhe zvogelimin e kostove. Pra ky certifikim do te beje te mundur qe Ofertuesit te ofrojne cilesi te mire me cmime te ulta.*

*ISO 14001:2015 ofron nne kuader praktik per shoqerite qe duan te menaxhojne rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtesisht ne strukturen e menaxhimit te biznesit per te kontrolluar impaktet qe aktivitetet, operacionet, produktet dhe sherbimet kane mbi mjedisin. AK gjykon se qdo Ofertues duhet te jete i pajisur me ISO 14001:2015 me qellim qe veprimtaria e ushtruar nga ana tij (ne rastin konkret realizimi i punes objekt prokurimi) te identifikojte impaktin ne mjedis gjate aktivitetit te saj si dhe te permiresoje performancen mjedisore duke zbatuar nje qasje sistematike. Pra ky certifikim do te beje te mundur qe Ofertuesit te ushtrojne veprimtarine duke pasur ne konsiderate parimin e mbrojtjes se mjedisit.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 është standard nderkombetare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2011 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sistemi i menaxhimit të Energjisë, është e nevojshme pasi një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të energjisë, pra, kur nevojat për energji janë gjithnjë në rritje, përdorimi efikas i energjisë në bazë të sistemit për menaxhimin e energjisë, AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove.

### **2.3.10** Grafiku i punimeve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
DREJTORIA JURIDIKE

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të*

*punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***